



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr

Dt: 23.01.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 17 shkronja e dhe g Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 59 të Ligjit për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera nr. 04/L-027 dhe Përfundimit nr. 06-6705-2/1 i miratuar nga Bordi i Drejtorëve me dt. 23.01.2015, më të cilin është përkrahur raporti dhe propozimi i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim për evakuimin e përkohshëm të familjeve të rrezikuara nga rrënimi i shtëpive për shkak të rrëshqitjes së tokës në segmentin e bregut të lumit Krena në rr. “Bajram Curri”, lagjja Gërçarë në Gjakovë, me dt. 23.01.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

I. Caktohet masa mbrojtëse për evakuimin e përkohshme të familjeve të rrezikuara nga rrënimi i shtëpive për shkak të rrëshqitjes së tokës në segmentin e bregut të lumit Krena në rrugën “Bajram Curri”, lagjja Gërçarë në Gjakovë, më këta kryefamiljarë:

1. Jeton Bytyqi
2. Elhami Hasi
3. Eldin (Ruzhdi) Vula
4. Neshet Pepaj
5. Hysen Delija
6. Zog Delija
7. Fatmir Morina
8. Blerim Bardhi
9. Hysen Babalija

II. Vendimi për evakuimin e banorëve të rrezikuar është miratuar si masë e përkohshme për garantimin e sigurisë së jetës së familjeve të kryefamiljarëve të përshkruar në pikën paraprake, ndërsa Komuna e Gjakovës do të përkujdesë për akomodimin dhe kujdesin për strehimin e tyre deri në krijimin e kushteve për siguri për jetë.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, ndërsa për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim në bashkëpunim me Stacionin e Policisë në Gjakovë.

IV. Vendimi iu dërgohet :

- Qytetarëve – kryefamiljarëve të përshkruar në pikën e parë të këtij vendimi
- Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim
- Stacionit të Policisë në Gjakovë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila

